



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**  
**V E N D I M**

Nr. 162 dt.29.11.1995

**MBI**  
**VENDOSJEN NE TIRANE TE DISA PLLAKAVE PERKUJTIMORE**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.11.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Kulturës “Mbi vendosjen në Tiranë të disa pllakave përkujtimore”, mbështetur në Ligjin Nr.7572, neni.14, dt.10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e Pushtetit Lokal”,

**VENDOSI**

1. Të vendosen pllaka përkujtimore në hyrje të qytetit “Studenti”, në kryqëzimin tek Liceu Artistik dhe në godinën Nr.15 të Qytetit “Studenti” me tekstet si më poshtë :

1.”KETU NE MESNATEN E 8 DHJETORIT 1990  
STUDENTE KONVIKTORE U NGRITEN NE  
DEMOSTRATEN E PARE KUNDER DIKTATURES  
DHE U PERLESHEN ME FORCAT POLICORE TE  
REGJIMIT KOMUNIST”.

2.”KETU ME 9 DHJETOR 1990 NE DEMOSTRATE  
KUNDER DIKTATURES KOMUNISTE, PER  
DEMOKRACI E PLURALIZEM POLITIK,

STUDENTE E QYTETARE TE TIRANES, U  
PERLESHEN ME FORCAT POLICORE TE REGJIMIT  
KOMUNIST”

3.”KETU ME 12 DHJETOR 1990 U SHPALL  
THEMELIMI NGA STUDENTE, PEDAGOGE,  
INTELEKTUALE DHE QYTETARE TE TIRANES  
DHE NISI AKTIVITETIN E VET PER DEMOKRACI E  
PARA PARTI ANTIKOMUNISTE NE SHQIPERI  
“PARTIA DEMOKRATIKE SHQIPTARE” DUKE  
LINDUR KESHTU PLURALIZMI POLITIK”

2. Të vendosen pllaka në vendet ku kanë banuar L.Poradeci,  
Hafiz Ibrahim Dalliu, Mitrush Kuteli, Eqerem Çabej.
3. Tekstet e pllakave të formulohen nga Seksioni i Kulturës.
4. Të bëhet një studim për vendosjen e pllakave  
përkujtimore dhe për figura të tjera patriotike e të  
kulturës tonë kombëtare.
5. Për zbatimin e vendimeve të mësipërme ngarkohet  
Seksioni i Kulturës dhe Drejtoria e Muzeumeve të  
Tiranës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**